

Një *vështrim* mbi
Treguesit e Zhvillimit
Ekonomik të
Shqipërisë

Sekretariati i Këshillit të Investimeve

Të dhëna të disponueshme
Janar - Qershor 2023





Ky publikim është një përmbledhje e treguesve kryesorë makroekonomikë në Shqipëri të publikuara nga burime zyrtare kombëtare dhe ndërkombëtare.


Ky dokument nuk paraqet pikëpamjet e Sekretariatit ose Këshillit të Investimeve.

▼ PËRMBAJTJA

- ▼ Llogaritë Kombëtare
 - ▼ Tregtia e Jashtme
 - ▼ Tregu i Punës
 - ▼ Investimet
 - ▼ Tregues Monetar

Një *vështrim* mbi
Treguesit e Zhvillimit
Ekonomik të Shqipërisë

6 8 3 5 0 3 1
4 0 1 8 3 6 9
2 4 6 6 3 6 1 6
5 1 7 4 8 3 7 0 3
5 4 7 0 6 0 2 5 1
9 4 4 6 3 2 4 4 4
7 1 3 7 8 0 0 0 7
9 6 3 5 9 3 8 5 2
6 0 8 9 2 1 6 8 3
4 0 5 8 6 0 1 2 4
8 3 4 7 5 1 3 3 0
8 1 0 0 8 9 7 7 4
4 0 2 3 5 6 1 8 8
0 3 5 0 1 9 1 8 5



ECURIA E TREGUESVE KRYESORE MAKROEKONOMIKË


Produkti i Brendshëm Bruto në tremujorin e parë të vitit **2023 vlerësohet me rritje prej 2,72%**, kundrejt tremujorit të parë të vitit 2022, me ndikimin kryesisht në aktivitete të pasurive të paluajtshme, Arte, argëtim dhe çlodhje; aktivitete të tjera shërbimi;

Përgjatë 6MI 2023, inflacioni mesatar me bazë vjetore **rregjistroi vlerën 5,6%**, në nivel të njëjtë me një viti më parë;

Gjatë TI 2023, fluksi hyrës i IHD u rrit me 1,7% krahasuar me një vit më parë, dhe janë ulur me 20,6% krahasuar me tremujorin paraardhës. Ndërkohë, gjatë TI 2023, stoku i IHD u rrit me 19,6% krahasuar me një vit më parë duke arritur **11.725 milionë Euro dhe 3,4% më shumë** se tremujori IV 2022;

Vende të tjera (konfidenciale) mbajnë vendin e parë me fluksin më të lartë të IHD-ve për TI 2023, e ndjekur nga Holanda dhe Italia. Ndërkohë, Zvicra vazhdon të udhëheqë stokun e IHD-ve në vend edhe për tremujorin I 2023;

Në TI 2023, bazuar në të dhëna e publikuara, shkalla e papunësisë u rrit me 0,1 p.p krahasuar me një tremujor më parë.




2.72%
RRITJE

5.6%
INFLACIONI

1.7%
RRITJA E IHD

RRITJA EKONOMIKE SIPAS TREMUJORËVE


Rritja tremujore PBB në %



Produkti i Brendshëm Bruto (P.B.B) në tremujorin e parë të vitit 2023 vlerësohet me rritje prej 2,72%, kundrejt tremujorit të parë të vitit 2022. Një vit më parë kjo rritje ishte 7,22%.

RRITJA EKONOMIKE SIPAS TREMUJORËVE

Rritja vjetore tremujore sipas aktiviteteve të ekonomisë




Burimi: INSTAT, Korrik 2023

Gjatë tremujorit I 2023, degët që janë rritur krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë janë Arte, argëtim dhe çlodhje; Administrata publike, Pasuritë e paluajtshme, Informacioni dhe komunikacioni, Tregtia dhe Industria. Degët që janë ulur krahasuar me një vit më parë janë Aktivitete shkencore dhe profesionale.

KONTRIBUTI NË RRITJA EKONOMIKE (TREMUJORE)

2023-TI Kontributi në rritje p.p sipas aktiviteteve të ekonomisë




Kontribut pozitiv në rritjen tremujore kanë dhënë degët: Aktivitete të pasurive të paluajtshme me +0,62p.p Arte, argëtim dhe çlodhje; aktivitete të tjera shërbimi me 0,60p.p, Administrata publike, Arsimi dhe Shëndetësia me +0,53p.p, Tregti, Transport, Akomodim dhe Shërbim ushqimor me +0,50p.p, Ndërtimi me +0,42p.p, Informacioni dhe Komunikacioni me +0,19p.p, Industri, Energji dhe Uji me +0,16p.p, Bujqësi, Pyje dhe Peshkim me +0,11p.p, Aktivitete Financiare dhe të Sigurimit me +0,10 p.p.

Negativisht kontriboi grupi: Aktivitete profesionale dhe Shërbime administrative me -0,14 p.p.

QARKULLIMI I MALLRAVE NË TREGTINË E JASHTME

Tregtia e jashtme, miliardë lekë



Burimi: INSTAT, Korrik 2023


Gjatë 6MI të vitit 2023 eksportet e mallrave arritën vlerën 234 mld lekë, duke u ulur me 7,4%, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 439 mld lekë, duke rënë me 1,6%, krahasuar me një vit më parë.

Deficiti tregtar arriti vlerën 205 mld lekë, duke u rritur me 6,2%, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2022.

Përqindja e mbulimit të eksporteve ndaj importeve zbriti në 53,3%.

QARKULLIMI I MALLRAVE NË TREGTINË E JASHTME

Importet sipas grupmallrave (në million lekë)




Burimi: INSTAT, Korrik 2023

Në 6MI 2023 importet janë ulur me 1,6 %, krahasuar me gjashtëmujorin e parë 2022. Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të importeve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -4,4 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -0,9 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me -0,5 pikë përqindje, etj.

Ndërsa, pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +4,4 pikë përqindje dhe “Produkte kimike dhe plastike” me +0,7 pikë përqindje.

QARKULLIMI I MALLRAVE NË TREGTINË E JASHTME

Exports (in million ALL)




Burimi: INSTAT, Korrik 2023

Eksportet, gjatë 6MI 2023 janë ulur me -7,4 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të eksporteve, janë: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -6,8 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -2,2 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me -1,0 pikë përqindje, etj.

Ndërsa, pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Ushqime, pije, duhan” me +2,1 pikë përqindje dhe “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +0,8 pikë përqindje.

IMPORTET E MALLRAVE


Struktura e Importeve (në %)



Struktura e importeve të mallrave gjatë 6M-I 2023 dominohet nga importet e Makineri, pajisje, Ushqimeve, pije, duhan dhe Materiale ndërtimi dhe metale.

EKSPORTET E MALLRAVE

Struktura e Eksporteve (në %)




Eksportet sipas produkteve vazhdojnë të ruajnë strukturën e tyre ku pjesa më e madhe janë Tekstile dhe Këpucë të ndjekur nga Materiale ndërtimi dhe metale dhe Minerale lëndë djegëse, energji elektrike.

- Ushqime, pije, duhan
- Produkte kimike dhe plastike
- Prodhime druri dhe letre
- Materiale ndërtimi dhe metale
- Të tjera
- Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike
- Lëkurë dhe artikuj prej lëkure
- Tekstile dhe këpucë
- Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi

Burimi: INSTAT, Korrik 2023

INDEKSI I ÇMIMIT TË KONSUMIT

Indeksi i Çmimeve të Konsumit, ndryshimi vjetor %




Burimi: INSTAT, Korrik 2023

Përgjatë 6MI 2023, inflacioni mesatar me bazë vjetore regjistroi vlerën 5,6%, në nivel të njëjtë me një viti më parë.

Bazuar në të dhënat e grafikut, duke filluar nga fundi i vitit 2011, inflacioni mujor me bazë vjetore ka qenë vazhdimisht poshtë objektivit të Bankës së Shqipërisë prej 3%, por tendeca rritëse janë vënë re duke filluar nga muaji Nëntor 2021, ku Inflacioni i regjistruar tejkaloi objektivin e BSH me ritme të larta dhe kjo tendencë vazhdoi deri në muajin tetor 2022 ku Inflacioni filloi rënien.

KURSI I KËMBIMIT


Kursi mesatar i këmbimit




Përgjatë 6M I të vitit 2023 kursi mesatar i këmbimit lekë/Euro ishte 112,9 ndërsa lekë/USD ishte 104,4

KREDIA PËR EKONOMINË

Totali i kredisë në ekonomi (mln Lekë)




Kredia e re 5MI 2023 sipas aktivitetit ekonomik mln Lekë



Kredia totale për ekonominë në Maj 2023 arriti në 712,6 miliardë lekë ndërsa shumica e kredisë së re gjatë 5MI të vitit 2023 shkoi në tregtinë me shumicë dhe pakicë, Ndërtimi dhe Industria përpunuese duke vazhduar të njëjtin trend të një viti më parë.

FORCA E PUNËS

Norma e papunësisë




Burimi: INSTAT, Korrik 2023

Në TI 2023, bazuar në të dhëna e publikuara, shkalla e papunësisë u rrit me 0,1 p.p krahasuar me një tremujor më parë.

Referuar të dhënave të INSTAT në tremujorin I 2023, numri i të punësuarve u rrit me rreth 5,042 persona krahasuar me një tremujor më parë.

PAGA MESATARE DHE PAGA MINIMALE

Paga mesatare me bazë mujore



Burimi: INSTAT, Korrik 2023

Paga mesatare gjatë TI 2023 (referuar të dhënave zyrtare të publikuara) është raportuar në 64.706 lekë me rënie nga tremujori paraardhës.


Paga mesatare mujore për një të punësuar në sektorin privat ishte 60.943 lekë me një rritje 2% krahasuar me një vit më parë ; Ndërkohë paga mesatare mujore për një të punësuar në sektorin shtetëror ishte 73.205 lekë , me një rënie 1,7% krahasuar me TIV 2022.

Shënim: të dhënat janë mesatare të shifrave tremujoreve publikuar nga INSTAT

I/19 II/19 III/19 IV/19 I/20
II/21 III/21 IV/21 I/22 II/22
II/20 III/20 IV/20 I/21
III/22 IV/22 I/23

PAGA MESATARE SIPAS SEKTORËVE (NË LEKË)

Paga mesatare mujore bruto sipas aktivitetit ekonomik




Pagat më të larta vazhdojnë të regjistrohen në sektorin e “Aktiviteteve financiare dhe sigurimit”, megjithëse me rënie nga një tremujor më parë, pasuar nga “Informacioni dhe Komunikimi”.

Pagat më të ulta janë raportuar në sektorin “Bujqësi, Silvikulturë dhe Peshkim”.


INVESTIMET E HUAJA DIREKTE

Fluksi hyrës IHD me bazë tremujore



Gjatë TI 2023, fluksi hyrës i IHD u rrit me 1,7% krahasuar me një vit më parë, dhe janë ulur me 20,6% krahasuar me tremujorin paraardhës.


Stoku IHD me bazë tremujore




Ndërkohë, gjatë TI 2023, stoku I IHD u rrit me 19,6% krahasuar me një vit më parë duke arritur 11.725 milionë Euro dhe 3,4% më shumë se tremujori IV 2022.

INVESTIMET E HUAJA DIREKTE

Stoku IHD sipas vendit të origjinës në mln Euro




Fluksi ID sipas shteteve në mln Euro



Vende të tjera (konfidenciale) mbajnë vendin e parë me fluksin më të lartë të IHD-ve për TI 2023, 66 milionë Euro e ndjekur nga Holanda me 62 milionë Euro dhe Italia me 43 milionë Euro. Ndërkohë, Zvicra vazhdon të udhëheqë stokun e IHD-ve në vend edhe për tremujjorin I 2023, me 1.914 milionë Euro me rënie të vazhdueshme të flukseve hyrëse.

INVESTIMET E HUAJA DIREKTE

Fluksi IHD sipas aktiviteteve kryesore në mln Euro



Burimi: Banka e Shqipërisë, Korrik 2023

Vende të tjera (konfidenciale) mbajnë vendin e parë me fluksin më të lartë të IHD-ve për TI 2023, 66 milionë Euro e ndjekur nga Holanda me 62 milionë Euro dhe Italia me 43 milionë Euro.

Ndërkohë, Zvicra vazhdon të udhëheqë stokun e IHD-ve në vend edhe për tremujjorin I 2023, me 1.914 milionë Euro me rënie të vazhdueshme të flukseve hyrëse.

RRETH KËSHILLIT TË INVESTIMEVE NË SHQIPËRI

Këshilli i Investimeve ka si qëllim rritjen e besimit të ndërsjellë midis biznesit dhe qeverisë duke kontribuar në institucionalizimin e dialogut mbi politikat në vend. Kontribuon në reformat kombëtare dhe procesin e tranzicionit ekonomik duke ndihmuar në përmirësimin e institucioneve, ligjeve dhe politikave që promovojnë mirëfunksionimin e tregut.

Sekretariati i Këshillit të Investimeve - Stafi

Puna e Këshillit të Investimeve mbështetet nga Sekretariati, një organ i pavarur me profesionistë të përzgjedhur dhe kontraktuar nga BERZH për t'u angazhuar drejtpërsëdrejti me komunitetin e biznesit.

Dr. Diana Leka (Angoni)

Drejtoreshë e Sekretariatit
lekad@investment.com.al

Elvis Zerva

Ekspert Ligjor dhe Rregullator
zervae@investment.com.al

Elida Fara

Eksperte Ekonomie
farae@investment.com.al

Xaira Shurdha

Eksperte për Monitorimin dhe Bashkëpunimin
shurdhax@investment.com.al

Elisa Lula


Oficere Administrative dhe Komunikimi
lulae@investment.com.al

Publikuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve (SKI), Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri
info@investment.com.al / www.investment.com.al / SKI është përgjegjës për përmbatjen e këtij publikimi.

 Albania Investment Council

 ALInvestCouncil

 Albania Investment Council



Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO

Këshilli i Investimeve mbështetet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, BERZH dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO).